

Tirsana - Energji për laktacionin

*Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe
Aksioneri i AUSTRIA Prämix shpk.*

*“Një fazë tranzicioni e suksesshme është çelësi për
rendimente të sigurta qumështi”*

Rreth laktacionit

Problemet e gjirit, thundrave dhe pjellorisë janë arsyt kryesore që ndikojnë në uljen e kohëzgjatjes së prodhimit në fermat e qumështit. Përgjegjës për këto probleme janë një shumëllojshmëri shqetësimesh të metabolizmit, shkaqet e të cilave mund të gjenden në laktacionin e mëparshëm ose më saktë në fazën e tranzicionit. Një arsye kryesore është bilanci energjistik negativ në fillim të laktacionit. Në këtë fazë marrja e ushqimit nuk mund të plotësojë nevojat për lëndë ushqyese që i duhen lopës për prodhimin e qumështit. Në këtë gjendje një reaksion fiziologjik normal i lopës është shkrirja e rezervave dhjamore. Rritja e acideve të lira yndyrore si pasojë e shkrirjes së këtyre rezervave, dëmton funksionalitetin e mëlçisë dhe kufizon aftësinë e saj për të prodhuar energji. Pasojat janë një rritje e përqendrimit të trupave ketonikë, ketoneve dhe një përkeqësim i gjendjes së ketozës.




Tirsana - Energji e lëngshme për mbështetjen e prodhimit të qumështit


Produktet Tirsana plotësojnë nevojat energjike të lopës në fazën e tranzicionit, direkt pas pjelljes ose gjatë laktacionit. Kombinimi i veçantë i substancave glukoplastike dhe lëndëve të tjera ushqyese furnizojnë lopën me energji të shpejtë dhe ndihmojnë metabolizmin. Kërkimet aktuale të universitetit të Goetingenit (Joering, 2014) vërtetojnë efektin e Tirsana në stabilizimin e metabolizmit dhe rendimentit të qumështit. Në një studim u vlerësua efekti gjatë fazës së tranzicionit në një grup prej 50 lopësh. Gjatë këtij studimi lopëve i'u dhanë racione ditore prej 200g Tirsana për lopë në ditë duke filluar nga java e tretë para pjelljes dhe 300g në fillim të laktacionit pas pjelljes. Gjatë monitorimit të vazhdueshëm të përqendrimit të ketoneve në gjak është vënë re një përmirësim i dukshëm i metabolizmit të kafshëve gjatë fazës së tranzicionit. Tirsana mund të përdoret në doza individuale duke u përzier në racionin ditor, ujë të pijshëm ose mund t'i jepet kafshës gjatë mjeljes.

Zhvillimi i furnizimit me ushqim kur përdoret TIRSANA BSK nëpërmjet ujit të pijshëm (10-15 ditë të laktacionit)

Furnizimi me TM (kg/ditë)



Kurba e laktacionit dhe të ushqyerit



Ne duam lopë me një vijueshmëri të njëtrajtshme të kurbës së laktacionit.

- Ato duhet të furnizohen në fillim të laktacionit me lëndë ushqyese të mjaftueshme.
- Lopë të tilla humbin pak peshë nëse ushqehen me parametrat e nevojshme
- Ato kanë më pak probleme në ndërzim.
- Rreziku i dëmtimit të mëlçisë (Acetonami) është më i ulët.

Ushqyerja në periudhën e parë të laktacionit

Lopët e reja në laktacion duan ushqim dhe vetëm ushqim.

- Menjëherë pas pjelljes, lopës duhet t'i jepet bar dhe 1 kg bërsi panxhari ose koncentrat
- Dhënia e ushqimit foragjer dhe rritja në sasi duhet të bëhet në mënyrë graduale.
- Sasia e koncentratit duhet të rritet gradualisht. Mbas javës së katërt duhet të rritet sasia e ushqimit që të arrijë në nivelet e nevojshme.

- Duhet shmangur acidoza e plëndësit, problemet me thundrat, problemet e fertilitetit dhe problemet me mbetjen e placentës.
- Duhet të ketë ushqim me përbërje energjike të mjaftueshme .
- Të parandalohet rënia në peshë e lopës në mënyrë që të shmanget rreziku i acetonemisë.

Një konsum i lartë ushqimi është kusht i rëndësishëm për rendiment të lartë të lopëve qumështit.

- Rendiment i lartë
- Shpërndarja e ushqimit me orar
- Cilësi ushqimi
- Ushqim me përmbajtje të lartë fibrash për tretje sa më të mirë
- Ushqim i mirëstrukturuar
- Bilanc i sasisë së ushqimit dhe vlerave ushqyese të tij
- Teknikë dhe radhë në të ushqyer
- Vakte të shpeshta ushqimore.

Furnizimi me ujë

- Lopët duhet të pijnë gjithmonë ujë të freskët dhe të pastër - **kontrolli i ujit të pijshëm është i domosdoshëm.**

Klima në stallë dhe rehatia e lopës

- Të tregohet kujdes për shëndetin e kafshës si për shembull: për thundrat, parazitët dhe stabilitetin e metabolizmit.
- Viçat duhet të mësohen të konsumojnë ushqim.
- Rritja e kujdesshme e Remontit.

Dhënia e ushqimit: 2-3 % e peshës së trupit për kg ushqim të thatë.

- **Përshembull:** Një lopë me peshë 700kg ka nevojë për 14-21 kg ushqim të thatë

Vlera optimal e pH të plëndësit tek lopët e qumështit është 6,5.

- Sekretionet dhe pështyma rregullojnë pH e zorrëve- sa më shumë të përtypet lopa, aq më shumë pështymë do të prodhohet.
- Efikasiteti strukturor i barit dhe silazhit të barit të thatë (35-45% masë e thatë) është i lartë ndërsa i silazhit të njomë, silazhit të misrit dhe tagjisë është më i ulët.

- Përpërgatitjen e silazhit të barit, bari nuk duhet prerë kur është nën 8 cm (normale është gjatësia 10-15 cm)
- Koncentrati nuk duhet të kalojë masën 2kg për vakt, përndryshe shtohet rreziku i acidozës.
- Rradha e ushqimit të jetë: bar- ushqim- koncentrat- silazh, sipas kërkesave përsëri koncentrat- bar ose racione të përziera

Balancimi i përmbajtjes së energjisë / proteinave në racionet e qumështit

- Mungesa në përmbajtje të proteinave dhe energjisë çojnë dobësimin e lopës dhe shkakton probleme fertiliteti.
- Deficitet e energjisë dhe teprica e proteinave të çojnë në rëndim të mëlçisë (acetonami) dhe probleme me pjellorinë.
- Teprica e energjisë çon në dhjamosjen e lopëve, më shpesh ndodh tek lopët e vjetra. Reduktimet e mëvonshme të dhjamesës tek lopët e reja çon në humbje peshe të rëndë, rëndim të mëlçisë (acetonami) dhe problem me pjellorinë.

Vlerat standarde të kontrollit të cilësisë së qumështit

- Përmbajtja e yndyrës: rreth 4%
- Përmbajtja e proteinave të qumështit: 3,2- 3,8%
- Diferenca ndërmjet përmbajtjes së yndyrës së qumështit dhe përmbajtjes së proteinave : <0,8%
- Përmbajtja e uresë në qumësht 15-30mg/100ml qumësht.
- Rendiment qumështi standard me persistencë konstante.

Ushqyerja në fazën e tretë të laktacionit

6- 8 javë para pjelljes, lopët hyjnë në periudhën e tharjes

- Vetëm gjinjtë e shëndetshëm mund të thahen. Duhet të kryhet testi shalm.
- Të trajtohen gjinjtë e sëmurë para periudhës së tharjes.
- Gjiri i lopës duhet të milet deri në pikë të fundit pastaj të thahet.

Lopët e vjetra të qumështit dhe lopët në tharje nuk duhet të dhjamosen

- Prandaj duhet të reduktohet koncentrati.
- Duhet t'i kushtohet vëmendje gjendjes së përgjithshme trupore, dhjamosjes dhe rënies nga pesha në të gjitha fazat e laktacionit.
- Syri i pronarit mund t'a ushqejë lopën siç duhet.

- Në pjesën e parë të laktacionit lopë të reja nuk duhet të humbin shumë peshë dhe të vjetrat nuk duhet të dhjamosen.

Ushqim i parapërgatitjes për pjellje

- Ushqimi i përgatitur duhet të fillohet 2-3 javë para pjelljes
- Duhet të jetë i varfër në kalcium dhe i pasur me fosfor
- Duhet të përdoret ose më mirë të shmanget ushqyerja me jonxhë, dhe tërfil.
- Mesatarisht 5 kg bar në ditë.
- 1.5-3 kg koncentrat në ditë, mundësisht 1 kg. krunde gruri të trashë.
- Përshtatje me ushqimin e laktacionit.
 - Kujdes! Tepërcate kalciumit mund të çojnë në sëmundje të etheve të qumështit.
 - Prandaj nuk duhet përdorur jonxhë apo silazh, jo shtim kalciumi dhe duhen shtuar përzierjet me lëndë minerale (Praemixe).